



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DIJOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 2186/2 Prot
Nr. 986 Dosje

PERMBARUES GJYQËSOR
AGIM SULÇE
Tiranë, më 28.08.2023

URDHËR
PËR MASEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
Adresa : Bly "Zhan D'Ark", prona nr.33, shtepia ushtarakeve, Tirane

Per dijeni : Shoqeria "ABC News" shpk
Adresa : Rr."Aleksander Moisiu", ish-Kinostudio, Tirane

Unë, Agim Sulçe, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit, Vendim Nr.7697 Akti të lëshuar më datë 24.07.2023 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përbarimore Nr. 986, datë 10.08.2023 kërkesën e kreditorit Shoqeria "Piranjat" shpk ndaj debitorit Shoqeria "ABC News" shpk.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për Ekzekutim Vullnetar me shkresën Nr.2183 Prot. Datë 16.08.2023, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, vendimi Nr. 7697 akti, datë 24.07.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, në referim të nenëve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile.

KONSTATOVA Se :

Në bazë të titullit ekzekutiv fatura tatimore shitje dhe urdhrit të ekzekutimit debitori Shoqeria "ABC News" shpk, detyrohet të paguajë shumën në total në vlerën 8,114,103 lëke.

URDHËROJ

Vendosjen e Sekuestros Konservative për bllokimin e Kuotave/Aksioneve të cilat rezultojnë në emër të debitorit Shoqeria "ABC News" shpk, me seli në Tirane, Rr."Aleksander Moisiu", ish-Kinostudio dhe me nr.NIPT: K01711004F.

Në rast mosbashkëpunimi nga ana juaj do të procedojmë me marrjen e masave administrative siç parashikon neni 606 i K.Pr.Civile.

Bashkëlidhur :Urdhër ekzekutimi, Vendim nr.7697 Akti, datë 24.07.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

PËRMBARUES GJYQËSOR
Agim Sulçe

Adresa: Rr. " Myslim Shyri" P.10, Sh.3, K. 2, Tirane, Tel./Faks #355 42400728 Cel/ 0692077578





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

NR.7697 AKTI
DT.REGJ.20.03.2023

DATA 24.07.2023

V E N D I M

“PER LESHIMIN E URDHERIT TE EKZEKUTIMIT”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

GJYQTARE : FATIME DEÇOLLI

Sot më datë 24.07.2023 mori në shqyrtim pa praninë e paleve, kërkesën që i përket :

- KERKUES:** Shoqëria "Piranjat" SH.P.K me administrator Taulant Koplikuj, me adresë për efekt njoftimi Rr.Barrikadave, pll 18, h6, ap 5. Tirane.
- OBJEKTI:** Leshimin e urdherit të ekzekutimit, për faturat tatimore nr 16 dt.21/12/2012 dhe nr 15 dt.07/12/2022.
- Baza ligjore:** Neni 511/d të K.Pr.Civile, neni 16 I ligjit 48/2014 " Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale e tregëtare".

Gjyqtari pasi administroi dhe shqyrtoi provat shkresore të depozituara nga kërkuësi së bashku me kërkesën për lëshimin e urdherit të ekzekutimit:

V Ë R E N:

Pala kërkuëse Shoqëria ""Piranjat" SH.P.K ", i është drejtuar gjykatës me kërkesën me objekt si më lartë cituar.

Nga aktet e depozituara me qëllim gjykimin e kërkesës nga kërkuësi, ka rezultuar se: Shoqëria "Piranjat" SH.P.K, është një shoqëri e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, kryesisht në fushën e prodhimit e programeve/emisioneve të ndryshme audiovizive etj.

Ndërmjet Shoqëria "Piranjat" SH.P.K dhe Shoqëria "ABC News "sh.a, e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar të QKB-së, me (NUIS) Nipt K01711004F, është krijuar një marrëdhënie tregtare ku midis palës kërkuëse Shoqëria "Piranjat" SH.P.K dhe Shoqërisë ABC News sha është lidhur Kontrata e shërbimit dt 10.08.2022 ku janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet e paleve dhe konkretisht për pagesat që kjo e fundit duhet të bëjë për shërbimet që kryhen nga pala kërkuëse.

Per periudhen nentor-dhjetor jane prere Faturat tatimore Nr.15 date 07.12.2022 dhe fatura Nr. 16 date 21.12.2022, afati I pagesave te te cilave sipas nenit 7 te Kontrates te Bashkepunimit, duhet te behej pas dates 10 Janar 2023.

Në perputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi për marrëdhënien e krijuar, pala kërkuese ka ofruar shërbimin përkatës për të cilin ndërmjet palëve janë nënshkruar dhe faturat përkatëse.

Konkretisht për detyrimin objekt shqyrtimi ndërmjet palëve janë nënshkruar:

faturat tatimore nr 16 dt 21/12/2012 ne vleren 3634740.00 leke dhe fature tatimore me nr 15 dt.07/12/2022 ne vleren 3701520.00 leke.

Nga aktet në dosje rezultojnë gjithashtu se shërbimet e realizuara nga kërkuesi, janë pranuar rregullisht nga debitori duke mos bërë asnjë rezervë, ose kundërshtim për aspekte të ndryshme të shërbimeve, si sasia, cilesia, etj.

Detyrimi sipas faturave tatimore te shitjes perfshin edhe vleren e tvsh se paguar.

Vertetohet se nga debitori nuk është shlyer teresisht detyrimi kontraktor për faturat e mesipër cituara.

Nisur nga sa më lart,rezulton nga aktet shkresore prove me fuqi të plotë provuese, kërkuesi ka parashtruar në kërkesën e tij drejtuar gjykatës se:

Pala jonë ka levruar mallrat sipas marrëveshjes dhe legjislacionit në fuqi, mallrat të cilat janë pranuar nga pala tjetër pa asnjë lloj kundërshtimi të shprehur, sikurse provohet nga nënshkrimi i faturave dhe situacioneve përkatëse:

Pala jonë ka deklaruar rregullisht faturat në fjale në organet tatimore dhe ka shlyer detyrimet perkatëse ligjore per keto fatura:

Nje kohe e konsiderueshme ka kaluar nga momenti kur faturat jane bere e pagueshme.

Si rrjedhojë e sa më sipër, nga kërkuesi vlerësohet se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të cilat bazuar në parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi i jepin të drejten të kërkojë leshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat objekt shqyrtimi, dhe të pretendojë edhe kamatevonesa dhe shperblimin per shpenzimet gjyqesore te postura per rikthimin e kredise.

ANALIZA LIGJORE E GJYKATËS:

Gjykata,duke pasur parasysh provat e paraqitura dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga Neni 510 e vijues i K.Pr.Civile ,çmon se duhet të pranohet kërkesa e paraqitur.

Neni 510 paragrafi i parë i K.Pr.Civile e lidh ekzekutimin e detyrueshëm vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv dhe sipas paragrafit të dytë gërma "e" të kësaj dispozite, janë të tilla: aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohen Zyra e Përmbanimit për ekzekutimin e tyre.

Ligji Nr.48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", ka parashikuar se: *"Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i dadua i tregu*

ë brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme”.

Kurse në nenin 16 të ligjit, është parashikuar se: 1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

3. Në lidhje me pagesën dhe kerkimin e saj në baze të ligjit Nr.48/2014 dt.24.04.2014, në nenin 6 të këtij ligji është parashikuar:

“Kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, llogaritja e kamatëvonesës fillon nga data, në të cilën debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin e tij, të kërkuar nga kreditori, sipas parashikimeve të nenit 463 të Kodit Civil. Kreditorit, të cilit debitori nuk i ka kundërshtuar furnizimin me mallra apo shërbime, i lind e drejta për të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga dita e nesërme pas datës së afatit të pagesës, të përcaktuar në kontratë.

Në ato raste kur debitori ka refuzuar të marrë në dorëzin mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Në rastet kur afati i pagesës nuk është i përcaktuar në kontratë, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga përfundimi i afateve si më poshtë:

a) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme;

b) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme;

c) kur debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara lëvrimit të mallrave ose shërbimeve, 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve;..”.

Nga shqyrtimi i faturave tatimore të shitjes të leshuara nga kërkuesi për shërbimet e kryera në favor të debitorit, gjykata emon se: a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm ligjor, faturat tatimore të shitjes, të leshuara nga kërkuesi, dhe paraqitur nga ai në cilësinë e provës shkresore, janë prova shkresore me fuqi të plotë provuese, sipas parashikimit të nenit 246 etj të K.Pr.Civile, e për rrjedhim edhe për këtë fakt, është titull ekzekutiv.

Në kushtet kur detyrimi që ajo përcakton për palen tjetër kontraktuese, debitori, nuk rezulton të jetë përmbushur në rrugë vullnetare brenda afateve ligjore të parashikuara në kontratë, këto detyrime janë bërë të kërkueshme.

Po kështu gjykata çmon se edhe kerkimi I kërkuarit per kamat vonesat dhe shpenzimet e tjera të bëra per ekzekutimin e detyrueshëm te faturës tatimore (e cila permban detyrimin), është I bazuar dhe duhet të pranohet rregullisht .

Kështu në lidhje me këtë disponim gjykata iu referua parashikimit se: 2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë (neni 16 I ligjit Nr.48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore tregtare)

Sa sipër, gjykata konkludon se kërkesa e ngritur nga kërkuari, është e bazuar në ligj dhe prova, dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata mbështetur në nenet 510/e, 511/fq të K.Pr.Civile

V E N D O S I

- Pranimin e kerkeses.
- Leshimin e urdherit te ekzekutimit per titujt ekzekutiv: *faturat tatimore nr 16 dt.21/12/2017 ne vleren 3634740.00 leke dhe fature tatimore me nr 15 dt.07/12/2022 ne vleren 3701520.00 leke.*
- Pagimin e kamatëvonesave dhe shpenzimeve gjyqësore sipas parashikimeve të Ligjit nr. 48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore tregtare" i ndryshuar, i ngarkohen debitorit "ABC News" sh.a.
- Urdherohet sherbimi permbarimor per ekzekutimin e ketij vendimi.
- Urdheri i ekzekutimit ilesihet vetem ne nje kopje.

U shpall ne Tirane më date 24.07.2023.

G J Y Q T A R E
FATIME DEÇOLLI

Shpenzime gjyqësore	Pala qe ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqësor			Sasi	Cmim	Vlera
	Gjykata	Padites	I Paditur			
Tarife gjyqësore		*			20	200
Shuma						200